

## DEPARTAMENTI I MARKETINGUT

### **I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkencë ekonomike në Departamentin e Marketingut**

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili "Marketing", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Shkencë Ekonomike, Menaxhim Marketing ose të përafërta me to.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare të ponderuar 8 e lart.
- c. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- d. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, menaxhim marketingut ose në fusha të përafërta.
- e. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- a. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- f. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili "Menaxhim Marketing", të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- g. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- h. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Menaxhim Marketingut ose të përafërta me to.
- i. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.

## II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Marketingut

<p><b>Mesatare Bachelor + Master</b> (max 100 pike, duke filluar nga 20 pike nota 8 (tete), per cdo 0.1, shtohet 4 pike)</p>	<p><b>Fusha e Studimit</b> (Marketing – 100 pikë, Shkenca Ekonomike 50 pikë, Shkenca të përafërta – 20 pikë)</p>	<p><b>Staf Akademik me kohe te plote</b> FT-UAMD – 100 pikë, Universitetet të tjera publike dhe jopublike - 50 pikë, Punonjës të institucioneve kërkimore shkencore – 20 pikë</p>	<p><b>Eksperienca ne mesimdhenie</b> Max 100 duke filluar nga 40 pike për 2 vite eksperiencë dhe 20 pikë për cdo vit shtese – max 5 vite vlerësim.</p>	<p><b>Publikime Shkencore</b> (Max 100 pike. 10 pike per cdo Aktivitet (5 x 10) dhe 10 pike për cdo botim (5x10)</p>	<p><b>PROJEKTI</b> (MAX 100 Pike, vleresim i udheheqesit)</p>	<p><b>TOTALI</b> (Max 600 pikë)</p>
--	--	---	--	--	---	-------------------------------------